

## Masat e emergjencës për kontrollin e objekteve ilegale

- Komponenti më i rëndësishëm në kuadrin ligjor austriak lidhur me masat e emergjencës për kontrollin e objekteve ilegale (armë, mallra të trafikuara, drogë) në automjete, apo shtëpi është ligji “Mbi policinë.” (Sicherheitspolizeigesetz).
- Kodi i Procedurës Penale përdoret nga gjykata për gjykimin e rasteve që lidhen me kontrollin e objekteve ilegale.
- Masat e emergjencës përcaktohen si në ligjin “Mbi policinë”, si dhe në Kodin e Procedurës Penale.
- Ligji “Mbi Sigurinë e Aviacionit” përmban dispozita të posaçme lidhur me masat e emergjencës për kontrollin e objekteve ilegale.
- Gjithashtu, ligji “Mbi kontrollin kufitar” përmban dispozita të posaçme lidhur me këto masa.

Sistemi ligjor, i ngritur mbi bazat e ligjit “Mbi policinë” përcakton, përsa u përket masave të emergjencës për kontrollin e objekteve ilegale, dispozitat e mëposhtme në përgjigje të çështjeve të ngritura përsa vijon:

- 1 Detyrat e policisë në mbrojtje të sigurisë – për shembull:
  - a. Neni 19: dhënia e ndihmës së përgjithshme
  - b. Veçanërisht neni 21: mbrojtja e sigurisë
  - c. Neni 22: mbrojtja parandaluese e interesave të ligjshëm
  - d. Neni 27 ruajtja e rendit publik
- 2 Kontrolli i proporcionalitetit sipas përcaktimeve të nenit 29
- 3 Autoriteti ligjor në përputhje me detyrat e policisë, për shembull:
  - a. Neni 39 e drejta për t’u futur në pronën private dhe për të kryer kontrolle të saj, veçanërisht kontrolle të dhomave dhe automjeteve
  - b. Neni 40 kontrolli i personave
  - c. Neni 41 autorizimi për kontrollin policor në raste të veçanta
  - d. Neni 42 Sekuestrimi i objekteve
  - e. Neni 49 dhënia e autoritetit të jashtëzakonshëm për lejet e kontrollit policor

- 4 Rast specifik: kontrolli i bagazheve dhe personave përpara hyrjes së zonës së sigurisë të aeroportit, shih nenet 3 dhe 5 të ligjit “Mbi sigurinë e aviacionit (LSG 2011)**
- 5 Nëse një sulm i rrezikshëm sipas përcaktimeve të nenit 16 të ligjit “Mbi policinë” (SPG) mund të klasifikohet si vepër penale e cila i kalohet gjykatës, procedurat e mëtejshme duhet të zhvillohen në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (StPO).
- a Në këto raste forcat e policisë (në funksionin e tyre si autoritet i rendit dhe i sigurisë), pra çdo punonjës i policisë, në bazën e nenit 18 të Kodit të Procedurës Penale ka të drejtën të ndërhyjë *ex officio* për të hetuar veprën e dyshuar penale (Nenet 2, dhe 99 të Kodit të Procedurës Penale)
  - b. Autoriteti për të ndaluar dhe sekuestruar sendet e dyshuara përcaktohet në nenet 110-115 të Kodit të Procedurës Penale.
  - c. Autoriteti për të kontrolluar mjedise, objekte apo persona përcaktohet në nenet 119-122 (e drejta e pronës është e mbrojtur, dhe kontrolli i shtëpisë është i mundur vetëm pas dhënies së autorizimit përkatës nga ana e një prokurori, dhe miratimit të këtij autorizimi nga gjykata; rregullat e posaçme për procedurën e autorizimit të përshpejtuar përcaktohen në nenin 120 të Kodit të Procedurës Penale).

**6 Rasti specifik: ligji “Mbi kontrollin kufitar” – e drejta për të kontrolluar personat, objektet dhe automjetet.**

Paragrafet e mëposhtëm përshkruajnë detyrat, obligimet, detyrimet e përmendura më lart. Lista e tyre është e përkthyer në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjuha gjermane në funksion të mundësisë të një qartësie sa më të madhe të terminologjisë ligjore.

- 1. Detyrat e policisë sipas shembullit të nenit 19.-:
  - a. Neni 19 Detyrimi për dhënien e ndihmës së përgjithshme

**Neni 19.**

(1) Në rast se verifikohet rrezikimi i jetës, shëndetit, lirisë dhe pronës së personave, apo nëse verifikohet mundësia e rrezikimit të jetës, shëndetit apo lirisë së pronës, atëherë organet e ruajtjes së rendit u lind detyrimi të japin ndihmën e tyre për shmangien e këtyre rreziqeve, në rastin kur, shmangia e rrezikut:

- 1. Përfshihet në fushëveprimin e ligjeve federale apo lokale, si dhe në kompetencat e administratës përgjegjëse për territorin ku është verifikuar rreziku ose

2. Përfshihet në fushën e kompetencave që lidhen me dhënien e ndihmës së shpejtë, apo të veprimeve të policisë për mbrojtjen kundër zjarrit.

(2) Në rast se ekzistojnë arsye të cila mbështesin supozimin se pritet të verifikohet rrezikimi i jetës, shëndetit, lirisë apo pronës sipas përcaktimeve të paragrafit 1, organet e ruajtjes së rendit janë të detyruara të konstatojnë nëse një rrezik i tillë ekziston në realitet. Nëse konstatohet ekzistenca e rrezikut, atëherë duhet të zbulohet burimi i rrezikut, dhe të jepet ndihma e menjëhershme. Në rast se ndodh që:

1. Verifikohet mundësia e një rreziku të natyrës së përgjithshme, shqyrtimi i tij dhe mbrojtja prej tij duhet të realizohen në kuadrin e mbrojtjes së sigurisë publike (që përshkruhet në kapitullin 2);

2. Nëse mbrojtja nga rrezikut të identifikuar i përket sferës së kompetencave të autoriteteve të tjera, si autoriteteve të mbrojtjes kundër zjarrit apo të autoriteteve të shpëtimit, duhen marrë masat për informimin dhe miratimin e tyre.

(3) Edhe nëse rreziku vazhdon të jetë prezent, detyrimi për të ofruar ndihmë të përgjithshme konsiderohet i ezauruar:

1. përkundrajt çdo të rrezikuari i cili (paragrafi 1) refuzon marrjen e ndihmës së mëtejshme.

2. në momentin kur konstatohet se mbrojtja nga rreziku nuk përfshihet në përcaktimet e paragrafit 1.

(4) Detyrimi për të ofruar ndihmë të natyrës së përgjithshme nga ana e organeve të ruajtjes së rendit publik vazhdon të jetë i vlefshëm edhe nëse mbrojtja nga rreziku është nën kompetencën e autoriteteve të tjera. Ky detyrim konsiderohet i ezauruar vetëm në çastin e hyrjes së veprim të autoriteteve kompetente të shpëtimit apo mbrojtjes nga zjarri.

## **b. Në veçanti neni 21: Mbrojtja nga rreziku**

### **Neni 21.**

(1) Organet e ruajtjes së rendit publik janë të detyruara të japin ndihmë për mbrojtjen nga rreziqet me natyrë të përgjithshme.

(2) Organet e ruajtjes së rendit publik kanë detyrën të ndalin menjëherë çdo sulm të rrezikshëm. Ligji federal përcakton kriteret për të konsideruar një individ të caktuar si të dyshuar për veprime të dënueshme.

(3) Organet e ruajtjes së rendit publik kanë detyrën të shqyrtojnë rreziqet e mundshme në mënyrë të zgjeruar. Me këtë kuptohet vëzhgimi:

1. I një personi i cili  
a) shprehet publikisht apo nëpërmjet komunikimit elektronik në favor të ushtrimit të dhunës përkundrejt njerëzve, objekteve, apo institucioneve kushtetuese, apo

b) I cili merr në pronësi mjete dhe fiton njohuri, të cilat i krijojnë mundësi për të shkaktuar dëme të përmasave të mëdha apo për të vënë në rrezik njerëz të tjerë, dhe i cili ka mundësinë të ushtrojë dhunë me baza fetare apo shoqërore, e cila rrezikon rendin dhe sigurinë publike, dhe

2. i përket një grupimi, në bashkëpunim me strukturat e të cilit, dhe në bashkëlidhje me zhvillimeve brenda të cilit, pritet të shkaktojë rreziqe të rënda nëpërmjet veprimeve kriminale, për sigurinë publike, veçanërisht nëpërmjet dhunës me motivim shoqëror apo fetar.

### **c. Neni 22 lidhur me mbrojtjen parandaluese të njerëzve dhe objekteve**

#### **Neni 22.**

(1) Organet e ruajtjes së rendit publik janë të detyruara të ofrojnë mbrojtje të veçantë:

1. Për njerëzit, të cilët nuk janë në gjendje të mbrohen vetë nga sulmet e rrezikshme;
2. Për institucionet kushtetuese dhe për funksionimin e papenguar të tyre;
3. Për përfaqësuesit e shteteve të huaja, organizatave ndërkombëtare dhe për subjektet e të drejtës ndërkombëtare, për mjediset publike dhe private në dispozicion të tyre, për personelin në shërbim të tyre, në përputhje me dispozitat dhe detyrimet përkatëse në kuadër të traktateve ndërkombëtare.
4. Për objektet, të cilave u mungon ruajtja e nevojshme nga pronari i tyre i ligjshëm pa vullnetin e këtij të fundit, dhe të cilat për këtë arsye nuk janë mjaftueshëmrisht të ruajtura nga sulmet e rrezikshme;
5. Për njerëzit, të cilët mund të japin informacion në lidhje me një sulm të rrezikshëm apo lidhur me një lidhje kriminale, dhe të cilët janë veçanërisht të rrezikuar, si dhe për të afërmit e rrezikuar të këtyre njerëzve.

(1a)

Marrja në dorëzim, ruajtja dhe dorëzimi i objekteve të harruara apo të humbura është detyrë e kryetarit të bashkisë i cili ka rolin e autoritetit që i merr këto objekte në dorëzim. Autoritetet përfaqësuese austriake janë të ngarkuara me marrjen në dorëzim të objekteve të humbura apo të harruara jashtë shtetit, dhe dorëzimi i tyre tek autoriteti që merr objektet në ngarkim sipas kompetencave të tij territoriale ndaj poseduesit të ligjshëm të këtyre objekteve, të cilëve këto objekte u jepen në dorëzim.

(2) Organet e ruajtjes së rendit publik janë të detyruara të parandalojnë sulmet që rrezikojnë jetën, shëndetin, lirinë, moralin, pasurinë dhe mjedisin, edhe në rastin kur këto sulme konsiderohen të mundshme.

(3) Pasi ka ndodhur një sulm i rrezikshëm, autoritetet përgjegjëse për ruajtjen e rendit janë të detyruara, pa asnjë paragjykim ndaj detyrave që duhet të kryejnë në përputhje me kodin e procedurës penale të vitit 1975 (StPO), BGBl Nr. 631/1975, të sqarojnë rrethanat e rastit, si dhe identitetin e personit përgjegjës, në mënyrë që të mundësohet parandalimi i sulmeve të tjera të rrezikshme. Nëse një person i caktuar dyshohet se ka kryer veprime të dënueshme, autoritetet përgjegjëse për ruajtjen e rendit do të zbatojnë dispozitat e kodit të procedurave penale, veçanërisht neni 53 paragrafi 1, 53a paragrafi. 2 deri 4 dhe 6, 57, 58 si 58a deri në d.

(4) Nëse autoritetet përgjegjëse për ruajtjen e rendit kanë arsye të besojnë se ekzistojnë mundësi për sulme ndaj jetës, shëndetit, lirisë apo pronës, ato janë të detyruara të vënë në dijeni njerëzit që mund të preken prej tyre. Nëse këta të fundit nuk kanë mundësi për të mbrojtur objektin e sulmit nëpërmjet marrjes së masave sipas mundësive të tyre, duke qenë se nuk janë në gjendje ta realizojnë këtë, atëherë kjo barrë u bie organeve të sigurisë. Nëse subjekti, prona apo pasuria e të cilit rrezikohet nga sulmi heq dorë shprehimisht nga mbrojtja, atëherë kjo mbrojtje nuk jepet, përveç rastit kur heqja dorë prej saj mund të dëmtojë moralin publik.

#### **d. Neni 27 Mbrojtja e rendit publik**

##### **Neni 27.**

(1) Organet e ruajtjes së rendit publik janë të detyruara të ruajnë rendin në të gjitha hapësirat publike. Në punën e tyre në mbrojtje të rendit ato duhet të tregojnë kujdes dhe vëmendje të veçantë për mbrojtjen e interesit të individit, si dhe të lirive dhe të drejtave pronësore dhe civile të tij.

(2) Hapësirat publike konsiderohen ato hapësira mbi të cilat asnjë person specifik apo rreth personash të paracaktuar nuk gëzojnë ekskluzivitet.

## **2. Kontrolli i parimit të proporcionalitetit sipas nenit 29**

### **Neni 29.**

(1) Nëse verifikohet domosdoshmëria e ndërhyrjes në të drejtat e njeriut (Neni 28a paragrafi 3), një ndërhyrje e tillë mund të kryhet vetëm në përpjesëtim të drejtë me shkakun e identifikuar dhe pasojën e synuar.

(2) Organet e sigurisë dhe të rendit publik duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë që:

1. Të zgjedhin, midis alternativave dhe autorizimeve të mundshme ato që kanë pritshmëritë më të pakta për të dëmtuar personat e përfshirë në veprimet e tyre.
2. Të përdorin përjasje të veçanta në varësi të faktit nëse masat e marra u drejtohen personave të papërfshirë në rastin e trajtuar, apo personave të cilët kanë shkaktuar rrezikun apo të cilët mund të quhen përgjegjës për të.
3. Suksesi i veprimit të tyre të jetë në përpjesëtim të drejtë me dëmet dhe rreziqet e shkaktuara për arritjen e tij.
4. Gjatë zbatimit të urdhërave dhe ushtrimit të detyrës të kujdesen për ruajtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të personave të prekur nga aksioni policor.
5. Të ndërpritet ushtrimi i forcës që në momentin e arritjes së rezultatit të synuar, apo që në çastin kur rezulton se ushtrimi i forcës nuk do të sjellë rezultat.

### **3. Një autorizim që përputhet me detyrat e organeve të rendit:**

- a. Neni 39 Hyrja në territoret, automjetet dhe hapësirat private

### **Neni 39.**

(1) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar të hyjnë në terrene, mjedise, si dhe mjete private të transportit ajror, tokësor dhe detar, në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre për të ofruar ndihmë apo për të përballuar një sulm të konsideruar të rrezikshëm.

(2) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar të hyjnë në terrene, mjedise, apo mjete transporti, në funksion të shmangies së përdorimit të lejueshëm të armëve të të gjitha llojeve.

(3) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar të kontrollojnë terrene, mjedise dhe mjete transporti, në funksion të:

1. Shpëtimin apo të ruajtjes së jetës apo shëndetit të një personi të rrezikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë;
2. Ndalimit të personit që është shkaktari i një rreziku të drejtpërdrejtë;
3. Pengimit të çdo veprimi apo mjete, që mund t'i shërbejë realizimit të një sulmi të rrezikshëm.

(4) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar të realizojnë kontrollin e mjeteve të transportit që qarkullon përmes rrugëve ndërkombëtare të transportit, apo në hapësirat në afërsi të aeroporteve, nëse mund të supozohet mbi bazën e fakteve të caktuara, se këto mjete transporti mund të kryejnë brenda dhe përtej kufirit veprime të dënueshme nga ligji. Në rast se kryerja e kontrollit kërkon hapjen e vulave doganore, veprimi i organeve të rendit publik realizohet në përputhje me përcaktimet e nenit 27 paragrafi 5 të kodit doganor, BGBl. Nr. 659/1994.

(5) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar të kontrollojnë objekte që gjenden brenda mjedisve private, dhe të hapin kutitë ku ato përmbahen, në rast se përmbushen parakushtet e përshkruara në paragrafin 3.

(6) Në të gjitha mjediset apo ndërtesat e mëdha publike, në të cilat sulmet kundër jetës apo shëndetit mund të prekin një numër veçanërisht të madh njerëzish, organet kompetente për ruajtjen e rendit publik kanë autorizimin për hapjen e kutive apo bagazheve, të cilat nuk janë në mënyrë të dukshme nën ruajtjen e një personi.

(7) Gjatë ushtrimit të kompetencave të përshkruara në paragrafin 3 deri në 6 duhet treguar kujdes i veçantë për ruajtjen e proporcionalitetit për ndërhyrjen në sferën e të drejtave të njerëzve të prekur prej veprimit policor (neni 29), dhe për shmangien e shkeljes së sekretit profesional. Përcaktimet e neneve 121, 122, paragrafet 2 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale mbeten në fuqi, përveç rastit kur këto përcaktime dëmtojnë qëllimin e masës së marrë.

(8) Përcaktimet e Kodit të Procedurës Penale zbatohen në mënyrë ekskluzive pas verifikimit të një sulmi të rrezikshëm gjatë kontrollit të territoreve, mjedisve, mjeteve dhe ambalazheve/kutive.

## **b. Neni 40 Kontrolli i personave**

#### **Neni 40.**

(1) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar të kryejnë kontrollin e personave të arrestuar, për t'u siguruar që këta të fundit nuk posedojnë mjete për të dëmtuar sigurinë e tyre dhe atë të të tjerëve, si dhe nuk kanë mundësi të arratisen.

(2) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar të kontrollojnë persona, nëse faktet e vërejtura japin arsye të mendohet se këta persona kanë lidhje me sulme kundër jetës, shëndetit, lirisë apo pronës, dhe se ata posedojnë mjete të rrezikshme.

(3) Autorizimet dhe kompetencat që u jepen organeve të sigurisë publike sipas përcaktimeve të paragrafëve 1 dhe 2 vlejnë edhe për hapjen dhe kontrollin e valixheve apo çantave në zotërim të personit të kontrolluar.

(4) Gjatë kontrolleve të realizuara sipas përcaktimeve të paragrafëve 1 dhe 2, organet kompetente për ruajtjen e rendit publik duhet të mjaftohen me kontrollin e veshjes dhe kontrollin e jashtëm të trupit, përveç rastit kur ekzistojnë arsye të mjaftueshme për të dyshuar se personi i kontrolluar mund të ketë fshehur një objekt në trupin e tij; në një rast të tillë, kontrolli i besohet një mjeku.

#### **c. Neni 41 Rregullorja e kontrolleve gjatë aktiviteteve masive**

##### **Neni 41.**

(1) Nëse ekzistojnë arsye për të besuar se gjatë një aktiviteti masiv do të ndodhin akte jo të veçuara dhune, apo se do të verifikohet një numër i madh sulmesh që rrezikojnë jetën apo shëndetin e njerëzve, organet e ngarkuara me ruajtjen e rendit publik kanë të drejtën ta kushtëzojnë hyrjen e njerëzve në vendin ku zhvillohet aktiviteti me kontrollin e veshjeve dhe çantave të personave pjesëmarrës. Ky nen nuk zbatohet në rastin e aktiviteteve dhe mbledhjeve që zhvillohen sipas përcaktimeve të ligjit mbi mbledhjet publike të vitit 1953.

(2) Udhëzimet e sigurisë të hartuara sipas përcaktimeve të paragrafit 1 duhet t'i bëhen me dije publikut në mënyrën më të përshtatshme, në funksion të informimit të një rrethi sa më të gjerë personash, veçanërisht nëpërmjet mediave; gjithësesi këto rregulla duhet t'i bëhen me dije publikut në ambientet ku zhvillohet aktiviteti. Këto udhëzime mund të mbulojnë njëkohësisht disa aktivitete që zhvillohen brenda një harku prej 48 orësh.

(3) Në rast se për një aktivitet masiv janë nxjerrë udhëzime për sigurinë në përputhje me paragrafin 1, organet e ruajtjes së sigurisë publike janë të autorizuar të kryejnë kontrollin fizik të personave në hyrje të aktivitetit (kontroll i veshjes dhe



i çantave të tyre). Në rast refuzimi të kontrollit nga ana e personave që dëshirojnë të marrin pjesë në aktivitet, autoritetet kanë të drejtën t'u ndalojnë atyre hyrjen, pa njohur pretendimin e rimbursimit të kostosë së biletës.

#### **d. Neni 42 Sekuestrimi**

##### **Neni 42.**

(1) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar, të vendosin masën e sekuestros ndaj objekteve, në rast se:

1. Një veprim i tillë i shërben ruajtjes së jetës, lirisë, shëndetit dhe pronës së njerëzve në rastin e një kërcënimi (të mëtejshëm) të saj,
2. këto objekte gjenden në prani të një personi të arrestuar, dhe kësisoj:
  - a) ato rrezikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë sigurinë e tyre fizike, apo sigurinë fizike të të tjerëve apo
  - b) ato mundësojnë apo ndihmojnë në arratisjen e të arrestuarit.
3. ato kërcënohen nga dëmtimi apo rrëmbimi, nëse pronari i tyre i ligjshëm nuk është në gjendje të kujdeset për ruajtjen e tyre;
4. ato gjenden nga autoritetet dhe askush nuk merr përgjegjësi për to.

Në rastet 1 dhe 2, personave të prekur nga kjo masë u jepet një konfirmim lidhur me vendosjen e masës për sekuestros së objekteve.

(2) Objektet e vendosura nën masën e sekuestros sipas përcaktimeve të paragrafëve 1 deri në 3, duhet të nxirren nga sekuestrimi që në momentin kur arsyja për mbajtjen e tyre në ruajtje bie. Në të kundërt, ato u kalojnë autoriteteve të sigurisë. Këto autoritete, në rast se nuk i bllokojnë këto objekte mbi bazën e dispozitave të një ligji tjetër, i mbajnë ato në ruajtje deri në shmangien e plotë të rrezikut që mund të shkaktohet prej tyre, dhe pastaj ua dorëzojnë ato pronarëve të ligjshëm. Objektet e sekuestruara trajtohen sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore në fuqi.

(3) Objektet e vendosura nën masën e sigurisë sipas paragrafit 1 dhe 4 i kalojnë në zotërim autoritetit kompetent sipas përcaktimeve të nenit 14, paragrafi 2, në rast se ato nuk mund t'i dorëzohen pronarit të ligjshëm, apo në rast se ato janë sekuestruar sipas përcaktimeve të një ligji tjetër.

## **e. Neni 49 Kompetenca për hartimin dhe zbatimin e rregulloreve të jashtëzakonshme**

**Neni 49.** (1) Në funksion të parandalimit të rrezikimit në shkallë të gjerë të jetës, shëndetit dhe pronës, organet e ruajtjes së rendit publik kanë të drejtën e hartimit dhe zbatimit të rregulloreve të jashtëzakonshme për ruajtjen e sigurisë, të cilat zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Shkelja apo moszbatimi i tyre dënohet me sanksione administrative.

(2) Zbatimi i drejtpërdrejtë dhe i detyrueshëm i këtyre rregulloreve kryhet ekskluzivisht nga organet e ngarkuara me ruajtjen e sigurisë publike, të cilat nuk mund të ushtrojnë kompetenca të tjera, përveçse atyre që u janë njohur shprehimisht nga kuadri ligjor federal.

(3) Këto rregullore anulohen në çastin kur arsyeja për zbatimin e tyre pushon së ekzistuari.

4. Për rastin e veçantë të kontrollit të bagazheve dhe personave përpara hyrjes në zonën e sigurisë së një aeroporti shih nenet 3 dhe 5 të ligjit për sigurinë e transportit ajror (LSG 2011)

## **Kontrolli fizik dhe kufizimi i hyrjes**

### **Neni 3.**

(1) Organet e sigurisë publike dhe organet e rendit publik janë të autorizuar të kushtëzojnë hyrjen e pasagjerëve në një zonë sigurie aeroportuale të përcaktuar si të tillë nga një program për garantimin e sigurisë në një aeroport civil, me kontrollin e veshjeve, bagazheve, dhe sendeve të tyre personale. Në rast se pasagjerët e refuzojnë kontrollin, atyre nuk u lejohet hyrja në zonën e sigurisë. Kontrolli manual i veshjeve kryhet nga një person i së njëjtës gjini. Nëse kontrolli mund të kryhet nëpërmjet mjeteve të tjera (si përshebull nëpërmjet skanerit), ai mund të kufizohet vetëm në përdorimin e këtyre mjeteve.

(2) Kufizimi i aksesit sipas paragrafit 1 nuk zbatohet në rastin e:

1. Personave, të cilëve u është besuar siguria në bordin e avionit në vendin ku është regjistruar kompania e fluturimit nga autoritetet kompetente të këtij vendi;
2. Organeve të rendit publik gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare;
3. Krerëve të shteteve, anëtarëve të qeverive, personaliteteve të krahasueshëm me ta dhe stafeve të tyre;

4. Personave në shoqërim të pjesëtarëve të stafeve të organeve të sigurisë publike, në rastin kur shoqërimi kryhet në kuadër të funksioneve të tyre zyrtare;

5. Personave, të cilëve u është lëshuar një autorizim për përjashtimin e tyre nga kufizimi i aksesit në zonën e sigurisë aeroportuale nga drejtori i policisë lokale që ka kompetencë mbi territorin e aeroportit. Ky autorizim mund t'u lëshohet vetëm personave që kryejnë funksione të njohura dhe të dëshmuara zyrtare në zonën e sigurisë së aeroportit.

Përcaktimet e tjera të shtjelluara nëpërmjet rregulloreve të kontrollit në përputhje me nenin 74, paragrafi 1 i ligjit për sigurinë ajrore (LFG) lidhur me hyrjen në këmbë apo me automjet të zonave të veçanta të sigurisë të një aeroporti civil, si dhe të drejtat e administratorit të aeroportit civil për të ndaluar hyrjen në këmbë apo me automjet, nuk ndryshojnë. Gjithashtu, nuk ndryshon e drejta e pronarit të një mjeti fluturues, për të ndaluar hyrjen e kujt do në këtë mjet, apo ta kushtëzojë hyrjen e një personi në të në varësi të gadishmërisë së tij për t'ia nënshtruar objektet e veta kontrollit, dhe t'i mohojë hyrjen çdokujt që nuk e pranon këtë kontroll.

(3) Në rast se gjatë kontrollit zbulohen objekte të cilësuar si të ndaluara në përputhje me paragrafin 1 të shtojcës 4-C të rregullores së BE Nr. 185/2010 apo në rregulloren e Ministrisë të Brendshme, atëherë mbartësi i tyre nuk lejohet të hyjë në zonën e sigurisë bashkë me këto objekte. Rregullorja e lartpërmendur e Ministrisë të Brendshme konsideron si objekte të palejueshme armët, eksplozivët, si dhe sende, mjete apo aparatura të tjera, të cilat mund të përdoren për ndërhyrje të jashtëligjshme, të cilat çënojnë sigurinë e transportit ajror.

(4) paragrafi 3 nuk zbatohet përkundërt objekteve të ndaluara, interesi i ligjshëm i transportit të të cilave ka marrë miratimin e organeve të ruajtjes së rendit publik, me kusht që ky transport të jetë miratuar paraprakisht nga kompania e transportit ajror.

(5) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar të zbatojnë kufizimin e aksesit të personave në zonën e sigurisë aeroportuale në përputhje me nenin 50, paragrafët 2 dhe 3 të SPG, nëpërmjet përdorimit të menjëhershëm të forcës.

(6) Mohimi i të drejtës së hyrjes nuk përbën bazë për pretendime për kompensimin e biletës.

## **Kontrolli i pasagjerëve**

**Neni 5.** Administratorët e aeroporteve të cilat kanë një trafik pasagjerësh prej të paktën 100,000 nisjesh në vit janë të detyruar, që përkundrejt organeve të ruajtjes së sigurisë publike:

1. Të garantojnë që çdo pasagjeri, përpara hyrjes së tij në një zonë sigurie aeroportuale, të përcaktuar si të tillë në përputhje me nenin 2 në programin e sigurisë së aeroportit, t'i kontrollohen bagazhet, si dhe sendet personale të tij, sipas përcaktimeve të nenit 3, paragrafët 1 deri në 3.
2. Të garantojnë, që kontrollet e pasagjerëve të kryhen me kujdesin më të madh ndaj tyre, dhe se kontrolli trupor i veshjeve të tyre të kryhet nga një person i së njëjtës gjini.
3. Të garantojnë një mbikqyrje të plotë të veprimtarisë së personelit të tyre,
4. Të lidhin kontrata siguracioni të detyrueshëm në funksion të mundësimit të kompensimit të dëmeve eventuale në përputhje me përcaktimet e nenit 8 paragrafi 2.
5. Të dërgojnë për kontrollin e pasagjerëve vetëm ata anëtarë të personelit, të cilët kanë miratimin e pa-anuluar me shkrim të dakordësisë së drejtorit të policisë lokale.
6. Të detyrojnë të gjithë anëtarët e stafit, të cilët kryejnë funksionin e kontrollit të pasagjerëve, të zbatojnë rregulloren për garantimin e cilësisë të kontrolleve të miratuar nga autoritetet e sigurisë apo nga një organ i ruajtjes së rendit publik
7. Të kryejnë kontrollin e cilësisë në përputhje me parimet e përcaktuara për autoritetet zyrtare të fushës në rregulloren e BE Nr. 300/2008 lidhur me specifikimet për kontrollin kombëtar të cilësisë së sigurisë së transportit ajror në aviacionin civil. Në fund të çdo tremujori duhet të paraqitë në Ministrinë e Brendshme një raport lidhur me masat e marra për garantimin e kontrollit të cilësisë dhe rezultatet e tyre.
8. Në rast se sulmi i rrezikshëm (sipas përcaktimeve të nenit 16 të Kodit Penal) ka arritur stadin e veprës ligjërisht të dënueshme, atëherë merren masat në përputhje me përcaktimet e kodit të procedurës penale lidhur me: rrezikun e përgjithshëm; sulmin e rrezikshëm; identifikimin e rreziqeve.

## **Neni 16.**

(1) Një rrezik i përgjithshëm verifikohet në rastin e

1. Një sulmi të rrezikshëm (paragrafi 2 dhe 3)

ose

2. Nëse tre apo më shumë njerëz bashkëpunojnë për kryerjen e veprimeve ligjërisht të dënueshëm (lidhje kriminale).

(2) Sulm i rrezikshëm konsiderohet kërcënimi i një të drejte ligjore nëpërmjet kryerjes së një vepre ligjërisht të dënueshme, e cila është konsumuar me paramendim, dhe që nuk ndiqet thjesht mbi bazën e kërkesës së një pale të përfshirë në të, por përmban elementë të e dënueshëm sipas:

1. Kodit Penal (StGB), BGBl. Nr. 60/1974, me përjashtim të veprave të dënueshme sipas neneve 278, 278a dhe 278b StGB, ose

2. Ligjit mbi ndalimin (Kodi Penal) StGBI. Nr. 13/1945, ose

3. Ligjit mbi kontrollin policor të të huajve 2005 (FPG), BGBl. I Nr. 100, ose

4. Ligjit mbi kontrollin e lëndëve narkotike (SMG), BGBl. I Nr. 112/1997, me përjashtim të blerjes apo posedimit të lëndëve narkotike për përdorim ekskluzivisht vetjak (Neni 27 paragrafi 2, 30 paragrafi 2 SMG), ose

5. Ligjit federal Anti-Doping të vitit 2007 (ADBG 2007), BGBl. I Nr. 30.

(3) Konsiderohet sulm i rrezikshëm edhe një sjellje që synon përgatitjen për realizimin e kërcënimit të përshkruar në paragrafin 2, nëse kjo sjellje verifikohet brenda një harku të ngushtë kohor, mjaft pranë konsumimit të veprës të dënueshme të synuar.

(4) Shqyrtim i rreziqeve konsiderohet verifikimi i burimeve të rreziqeve si dhe identifikimi i rrethanave që mund të ndikojnë për t'u mbrojtur prej tij.

Policia kriminale (në kuptimin e autoritetit të sigurisë, si dhe në kuptimin e çdo polici, sipas përcaktimeve të nenit 18 të Kodit të Procedurës Penale) ka detyrën që të ndjekë rrugën zyrtare për sqarimin e dyshimeve për konsumimin e një veprimi ligjërisht të dënueshëm (nenet 2 dhe 99 të Kodit të Procedurës Penale).

## **Policia kriminale**

## **Neni 18.**

(1) Policia kriminale punon për realizimin e detyrave në shërbim të goditjes së veprave penale (neni 10, paragrafi 1 Z 6 B-VG), veçanërisht në funksion të zbulimit dhe ndjekjes së veprave penale sipas dispozitave të këtij ligji.

(2) Policia kriminale punon nën drejtimin e autoriteteve të sigurisë, organizimi dhe jurisdiksioni territorial i të cilave përcaktohet në ligjin e policisë. Të gjitha detyrat dhe kompetencat që u jepen autoriteteve të sigurisë sipas dispozitave të këtij ligji, u përkasin edhe organeve që punojnë nën komandën dhe në jurisdiksionin e tyre në funksion të mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike.

(3) Termi “polici kriminale” i përdorur në këtë ligj përfshin organet e sigurisë dhe rajonet përkatëse të policisë, si dhe strukturat e tyre (paragrafi 2), të përfshira në ushtrimin e detyrave të luftës kundër krimit.

## **Hetimi kryesisht**

### **Neni 2.**

(1) Policia kriminale dhe prokuroria janë të detyruara, në kuadër të përmbushjes së detyrave të tyre të hetojnë kryesisht çdo dyshim lidhur me një vepër ligjërisht të dënueshme, pavarësisht nga kërkesa e personave që gëzojnë të drejtën e ligjshme të paraqitjes së kërkesës për fillimin e hetimeve.

(2) Gjatë procesit gjyqësor, gjykata është e detyruar të shqyrtojë dhe sqarojë kryesisht veprën ligjërisht të dënueshme e cila përbën bazën e padisë ndaj të akuzuarit.

## **Hetimet**

### **Neni 99.**

(1) Policia kriminale heton kryesisht ose pas paraqitjes së një kallëzimi; ajo zbaton dhe ndjek urdhërat e prokurorisë dhe gjykatës (Neni 105 paragrafi 2).

(2) Edhe nëse është e nevojshme marrja e autorizimit nga prokuroria për realizimin e hetimeve, në rast urgjence, policia kriminale mund t'i kryejë ato edhe në mungesë të tyre. Në këto raste, policia kriminale duhet ta kërkojë autorizimin e prokurorisë sa më shpejt të jetë e mundur (Neni 100 paragrafi 2 Z 2); në rast se prokuroria nuk jep autorizimin, hetimi pushohet menjëherë, dhe situata kthehet, me sa të jetë e mundur, në gjendjen e mëparshme.

(3) Në rast se rregullorja parashikon marrjen e autorizimit nga gjykata për kryerjen e hetimeve, atëherë ndërmarrja e hetimeve në rast urgjence nga ana e policisë

kriminale është e lejueshme, vetëm atëherë kur kjo përcaktohet shprehimisht në ligj.

(4) Shtyrja e hetimeve nga ana e policisë kriminale është e lejueshme vetëm atëherë kur:

1. Kjo shtyrje është e nevojshme për të mundësuar sqarimin e një veprë penale më të rëndë, kur është e nevojshme ndjekja e njërit prej pjesëmarrësve në veprën penale, dhe kur shtyrja nuk shkakton rreziqe serioze për jetën, shëndetin, apo lirinë e të tretëve, ose:

2. Kjo shtyrje është e nevojshme për të shmangur një rrezik serioz ndaj jetës, shëndetit, apo lirisë së një personit, në rastin kur shtyrja është mënyra e vetme për shmangien e këtij rreziku.

(5) Policia kriminale duhet të lajmërojë menjëherë prokurorinë lidhur me shtyrjen e nisjes së hetimeve në përputhje me përcaktimet e paragrafit 4. Në rastin e një dërgese të kontrolluar, e cila ka të bëjë me transportin drejt territorit shtetëror apo jashtë territorit shtetëror të mallrave të kufizuara apo të ndaluara, pa qenë e nevojshme ndërhyrja e prokurorisë sipas përcaktimeve të nenit 1 paragrafi 2, zbatohen përcaktimet e neneve 71 dhe 72 të ligjit mbi bashkëpunimin gjyqësor me vendet anëtare të BE

b. Autorizimi për sekuestrimin deri në konfiskimin (me vendim gjykate) e një objekti shtjellohet në nenet 110 – 115 të Kodit të Procedurës Penale.

## **Sekuestrimi**

### **Neni 110.**

(1) Sekuestrimi lejohet nëse:

1. Kryhet në funksion të sigurimit të provave
2. Kryhet në funksion të garantimit të pretendimeve të ligjshme private
3. Kryhet në funksion të konfiskimit (Neni 19a Kodi Penal), pas degradimit të objektit (neni 20, KP), degradimit të rëndë të objektit (neni 20b KP), në funksion të tërheqjes nga qarkullimi (neni 26 KP), apo mbi bazën e rregulloreve ligjore në fuqi lidhur me sekuestrimin e pasurive.

(2) Sekuestrimi duhet të kërkohet nga prokuroria. Urdhri i prokurorisë zbatohet nga policia kriminale.

(3) Policia kriminale ka të drejtën të sekuestrojë një objekt me iniciativën e vet, në përputhje me përcaktimet e nenit 109 Z 1 lit. A,

1. Atëherë kur:
  - a. Objekti është i braktisur
  - b. Objekti i është marrë viktimës gjatë pësimit të veprës të dënueshme të kryer ndaj tij.
  - c. Objekti është gjetur në vendin e krimit dhe është përdorur për kryerjen e tij, apo ishte parashikuar për kryerjen e tij
  - d. Objekti ka vlerë të vogël dhe është lehtësisht i zëvendësueshëm
2. Ndalohet posedimi i këtij objekti (Neni 445a paragrafi 1),
3. Objekti ka qenë në posedim të personit të arrestuar sipas përcaktimeve të nenit 170, paragrafi 1 Z 1, apo është gjetur në kuadër të një kontrolli të kryer në përputhje me nenin 120, paragrafi 1.

4. Në rastet e përcaktuara në nenin 4 të rregullores Nr. 1383/2003 të Këshillit Evropian të datës 22 qershor 2003 lidhur me trajtimin e mallrave, për të cilat autoritetet doganore dyshojnë se mund të çenojnë të drejta të caktuara të pronësisë intelektuale, dhe lidhur me masat që merren ndaj mallrave, që aktualisht i shkelin këto të drejta (Gazeta Zyrtare Nr. L 196 e datës 02/08/2003 S. 0007 - 0014).

(4) Konfiskimi i objekteve në funksion të sigurimit të provave (paragrafi 1 Z 1) nuk lejohet, apo shfuqizohet me kërkesë të personit të prekur prej tij, në rast se prova mund të sigurohet nëpërmjet mjeteve filmike, zanore apo regjistrimeve të tjera, apo nëpërmjet kopjeve të shënimeve të shkruara ose të dhënave të përpunuara në mënyrë automatike, dhe nëse nuk ka gjasa që objektet e sekuestruara apo materialet origjinale të informacionit të sekuestruar të merren në shqyrtim si provë fizike gjatë procesit gjyqësor.

#### **Neni 111.**

(1) Çdo person, i cili posedon objekte apo vlera pasurore që duhet t'i nënshtrohen konfiskimit është i detyruar (Neni 93 paragrafi 2) t'i dorëzojë ato me kërkesë të policisë kriminale apo të mundësojë sekuestrimin në një mënyrë tjetër. Ky detyrim mund të plotësohet, nëse është e nevojshme dhe nëpërmjet kontrollit të personave apo banesave, në përputhje me zbatimin e përcaktimeve të dhëna në nenet 119 deri në 122.

(2) Në rast se konfiskimi i informacionit që përmbahet në format numerik në disqe të ngurtë është i nevojshëm, çdokush është i detyruar të mundësojë aksesin në këtë informacion, dhe të vërë në dispozicion një mbartës informacioni elektronik që mundëson leximin e informacionin e kërkuar. Gjithashtu, është i lejueshëm kopjimi i të dhënave të kërkuara në funksion të krijimit të një kopjeje sigurie të informacionit elektronik.



(3) Personat, të cilët nuk janë të akuzuar për kryerjen e veprës penale, në rast se paraqesin kërkesë, duhet të kompensohen në mënyrë të arsyeshme dhe me çmimet e tregut, për kostot që u janë shkaktuar nëpërmjet marrjes së dokumentave, kopjeve të dokumentave apo mjeteve të tjera që përdorin për ushtrimin e profesionit të tyre në funksion të sigurimit të provës gjatë procesit hetimor.

(4) Në çdo rast, personat e prekur nga sekuestrimi i mjeteve, sendeve apo pasurive duhet të informohen menjëherë, apo brenda 24 orëve nëpërmjet një konfirmimi të sekuestros lidhur me sekuestrimin. Ata gjithashtu duhet të informohen lidhur me të drejtën për të kërkuar heqjen e sekuestros (neni 106), dhe për të filluar procedurat për të marrë një vendim gjykatë lidhur me ndërprerjen apo vazhdimin e sekuestros (neni 115). Në rastin e një sekuestroje që synon sigurimin e materialeve që lidhen me pretendime të ngritura në fushën e së drejtës private (Neni 110 paragrafi 1 Z 2), është i nevojshëm, brenda mundësive, informimi i viktimës.

#### **Neni 112.**

(1) Në rast se personi që preket nga sekuestroja kundërshton zbatimin e saj, duke iu referuar të drejtës ligjore për ruajtjen e konfidencialitetit, e cila nuk mund të anashkalohet edhe në rastin kur ky person është vetë i akuzuari për kryerjen e veprës ligjërisht të dënueshme, atëherë dokumentat apo të dhënat elektronike duhet të sigurohen në mënyrën më të përshtatshme ndaj aksesit apo ndryshimeve të paautorizuara, duke iu dorëzuar gjykatës.

Nëse personi i prekur nga sekuestroja paraqet një kërkesë, dokumentacioni i sekuestruar depozitohet në prokurori, dhe ruhet veçmas nga aktet e hetimit. Në të dyja rastet këto dokumenta nuk mund të shqyrtohen nga prokuroria apo nga policia kriminale, deri në çastin kur merret vendimi lidhur me hapjen e tyre, i cili shtjellohet në paragrafet e mëposhtëm.

(2) Personi i prekur nga sekuestroja ftohet, brenda një afati të arsyeshëm që nuk i kalon 14 ditët, që të tregojë në mënyrë konkrete ato pjesë të shënimeve apo të dhënave elektronike, hapja e të cilave do të shkaktonte shmangie ndaj së drejtës për ruajtjen e konfidencialitetit të tij. Për këtë qëllim, personit i lind e drejta e shqyrtimit të dokumentave të sekuestruara dhe të depozituara. Në rast se personi i prekur nga sekuestroja nuk e përdor këtë të drejtë, atëherë dokumentat e sekuestruara i bashkangjiten aktit të akuzës dhe vlerësohen. Në rastin e kundërt, gjykata/prokuroria, nëse merr në dorëzim një kërkesë të paraqitur sipas fjalisë së parafundit të paragrafit 1, vendos, që në prani të personit të prekur nga sekuestroja, stafit mbështetës apo të një eksperti, të shqyrtojë dokumentacionin e sekuestruar dhe të marrë një vendim nëse, dhe në çfarë mase këto ky dokumentacion do të shtohet në aktet e çështjes. Dokumentat që nuk shtohen në aktet e çështjes i kthehen palës së prekur nga sekuestroja. Në mungesë të shfuqizimit të kriterit të konfidencialitetit, informacioni i marrë nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk mund të përdoret në funksion të hetimeve të mëtejshme apo në cilësinë e provës.

(3) Pala e prekur nga sekuestroja mund të kundërshtojë vendimin e prokurorisë. Në këtë rast, dokumentacioni i paraqitet gjykatës, e cila merr vendim, nëse, dhe në çfarë mase dokumentacioni do t'u bashkangjitet akteve. Paragrafi 2, fjalia e fundit mbetet në fuqi. Ankesa ndaj vendimit të gjykatës ka efekt vonues ndaj procesit.

### **Neni 113.**

(1) Sekuesroja mbaron kur,

1. Anulohet nga policia kriminale (paragrafi 2),
2. Kur prokuroria urdhëron fundin e saj (paragrafi 3),
3. Kur gjykata merr vendimin për konfiskim.

(2) Policia kriminale duhet të informojë prokurorinë sa më parë që të jetë e mundur lidhur me çdo sekuestrim, por sidoqoftë brenda një afati maksimal prej 14 ditësh (Neni 100 paragrafi 2 Z 2), me përjashtim të rastit kur ajo vetë e ka anuluar sekuestron mbi bazat e nenit 110, paragrafi 3, për shkak të mungesës apo zhvleftësimit të arsyeve të sekuestrës. Njoftimi i policisë kriminale mund të bëhet në mënyrë të njëkohshme me njoftimin e ardhshëm të radhës, me kusht që kjo gjë të mos çënojë interesat thelbësore të procesit apo të personave të përfshirë në të, në rast se vlera e objekteve të sekuestruara është e papërfillshme, në rast se këto objekte nuk posedohen nga askush, si dhe në rastin kur pronësia e tyre është e ndaluar (Neni 445a paragrafi 1). Në rastet e parashikuara nga neni 110 paragrafi 3 Z 4, policia kriminale vepron në përputhje me përcaktimet e neneve 3, 4 dhe 6 të Ligjit kundër Piraterisë së Produkteve, të vitit 2004, BGBl. I Nr. 56/2004.

(3) Prokuroria, në rastin e një sekuestroje të realizuar sipas përcaktimeve të nenit 109 Z 1 lit. b duhet t'i kërkojë gjykatës konfiskimin, dhe, në rast se mungojnë parakushtet për këtë, të japë urdhër për anulimin e sekuestrës.

(4) Në rastin e sekuestrës së objekteve (Neni 109 Z 1 lit. a), konfiskimi sipas kërkesës nuk kryhet, nëse sekuestroja ka të bëjë me objekte të sekuestruara sipas përcaktimeve të nenit 110 paragrafi 3 Z 1 lit. a, d ose Z 2, apo nëse qëllimi i sekuestrës mund të përmbushet nëpërmjet marrjes së masave të tjera administrative. Në këto raste, prokuroria ka kompetencat e nevojshme mbi objektet e sekuestruara, në mënyrë që të marrë masat për mbajtjen e tyre të mëtejshme nën ruajtje, apo, nëse është e nevojshme, të urdhërojë anulimin e sekuestrës.

**Neni 114.** (1) Ruajtja e objekteve të sekuestruara, deri në paraqitjen e raportit mbi sekuestron (Neni 113 paragrafi 2) është detyrë e policisë kriminale, pastaj e prokurorisë.

(2) Nëse nuk ka më arsye për mbajtjen e mëtejshme nën sekuestro të objekteve të sekuestruara, atëherë këto objekte u kthehen në çastin më të parë personit prej të

cilëve ato janë marrë, përveç rastit kur personi në fjalë qartësisht nuk ka të drejtë ligjore për posedimin e tyre. Në këtë rast, objektet e sekuestruara i kthehen personit i cili është pronari i tyre legjitim. Në rast se ky person nuk mund të gjendet, dhe nuk mund të identifikohet në mungesë të një përpjekjeje disproporcionale për gjetjen e tij, ato depozitohen në mënyrë ligjore sipas nenit 1425 ABGB. Lidhur me këtë njoftohen personat e prekur.

**Neni 115.** (1) Konfiskimi është i lejueshëm, atëherë kur objektet e sekuestruara pritet që:

1. Të jenë të nevojshme në cilësinë e provës gjatë procesit gjyqësor,
2. Ndaj tyre ekzistojnë pretendime në kuadër të së drejtës private (Neni 367)
3. Do të shërbejnë për të siguruar një vendim gjykate për konfiskim (Neni 19a StGB), për degradim të objektit (Neni 20 StGB), për degradim të zgjeruar të objektit (Neni 20b StGB), për nxjerrje nga qarkullimi të tij (Neni 26 StGB) apo për çfarëdo vendimi tjetër gjykate që rregullon situatën pronësore, zbatimi i të cilit, në mungesë të konfiskimit do të rrezikohej apo vështirësohej së tepërmi.

(2) Me kërkesë të prokurorisë, apo të personit të prekur nga sekuestrimi, gjykata duhet të marrë menjëherë vendim lidhur me konfiskimin.

(3) Neni 110 paragrafi 4 mbetet në fuqi. Nëse është e nevojshme, konfiskimi duhet të kufizohet tek regjistrimet dhe kopjet e përcaktuara në këtë nen.

(4) Në rastin e një konfiskimi të mbështetur nga përjashtimi i të tretëve dhe nga ndalimi i tjetërsimit apo kompensimit të pronës (Neni 109 Z 2 lit. b) zbatohen përcaktimet lidhur me rregulloren e ekzekutimit të vendimit, përveç rastit kur ligji shprehet ndryshe.

(5) Vendimi, me të cilin konfiskimi miratohet me synim sigurimin e një vendimi gjyqësor që ka për objekt degradimin e sendit të konfiskuar (Neni 20 StGB) apo degradimi të zgjeruar (Neni 20b StGB), duhet të përcaktojë një shumë parash, e cila mbulon vlerën financiare të pasurive të deklaruara si të degraduara.

(6) Në rast se parakushtet për konfiskimin e objektit nuk ekzistojnë apo pushojnë së ekzistuari, apo në rast se depozitohet një shumë parash sipas përcaktimeve të paragrafit 5, atëherë prokuroria, pas paraqitjes së akuzës në gjykatë, është e detyruar të anulojë konfiskimin.

c. Autorizimi për kontrollin e mjediseve, objekteve apo personave përcaktohet në nenet 119-122 (e drejta e pronës private është e mbrojtur, ekziston nevoja e një mandati kontrolli të miratuar nga prokuroria. Policia kriminale ka të drejtën e zbatimit të procedurave të përshpejtuara në rast rreziku sipas përcaktimeve të nenit 120).

## **Kontrolli i mjediseve, objekteve dhe personave**

### **Neni 119.**

(1) Kontrolli i mjediseve dhe objekteve (Neni 117 Z 2) është i lejueshëm, nëse ekzistojnë arsye të besueshme të mendohet se në këto mjedise dhe objekte fshihet një person i cili dyshohet se ka kryer një veprë të dënueshme, apo në to gjenden objekte apo gjurmë, të cilat duhet të sekuestrohen apo hetohen.

(2) Kontrolli i personit (Neni 117 Z 3) është i lejueshëm, nëse personi:

1. Është arrestuar apo është kapur në flagrancë,
2. Dyshohet se ka kryer një veprë të dënueshme, dhe ekzistojnë arsye të mendohet se ky person mbart objekte, të cilat duhet të sekuestrohen, apo që mund të shqyrtohen si gjurmë që të çojnë tek vepra e dënueshme.
3. Ka pësuar dëmtime apo ndryshime trupore si pasojë e një veprë të dënueshme, konstatimi i të cilave është i nevojshëm për qëllimet e një procesi gjyqësor.

### **Neni 120.**

(1) Kontrollat e mjediseve dhe objekteve sipas përcaktimeve të nenit 117 Z 2 lit. b dhe kontrollat e personave sipas përcaktimeve të nenit 117 Z 3 lit. b urdhërohen nga prokuroria mbi bazën e një autorizimi të gjykatës; në rast se vonesa në dhënien e autorizimit mund të rrezikojë rezultatet e hetimit, policia kriminale ka të drejtën ta kryejnë kontrollin pa urdhërin e prokurorit apo autorizimin e gjykatës. Kjo vlen edhe në rastet e parapara nga neni 170, paragrafi 1 Z 1 lidhur me kontrollin e personave, gjithashtu i përcaktuar në nenin 117 Z 3 lit. b. Por në asnjë mënyrë viktima nuk mund të detyrohet që t'i nënshtrohet kontrollit kundër dëshirës (neni 119 paragrafi 2 Z 3 dhe neni 121 paragrafi 1 fjalia e fundit).

(2) Policia kriminale mund t'i kryejë kontrollat sipas përcaktimeve të nenit 117 Z 2 lit. a dhe nenit 117 Z 3 lit. a në mënyrë të drejtpërdrejtë.

### **Neni 121.**

(1) Personi i cili do t'i nënshtrohet kontrollit nga ana e policisë duhet të informohet lidhur me qëllimet dhe arsyet e kontrollit. Atij duhet t'i kërkohet të lejojë kontrollin apo të japë objektin e kërkuar me vullnetin e tij të lirë. Ky komunikim

mund të mos kryhet vetëm në rastin kur urgjenca e rastit nuk e lejon një gjë të tillë, si dhe në rastin e parashikuar në dispozitat e nenit 119 paragrafi 2 Z 1. Përdorimi i forcës (Neni 93) nuk është i lejueshëm në rastin e kontrollit të personit, sipas përcaktimeve të paragrafit paragrafi 2 Z 3 të nenit 119.

(2) Personi i cili preket nga kontrolli i mjediseve të tij, ka të drejtë, sipas përcaktimeve të nenit 117 Z 2, të jetë i pranishëm gjatë kontrollit, qoftë personalisht, qoftë nëpërmjet sjelljes të një personi të besuar prej tij, sipas përcaktimeve të nenit 117 Z 3 lit. b. Në rastin e sjelljes së këtij personi vlejnë edhe përcaktimet e nenit 160 paragrafi 2. Nëse pronari i banesës që do të kontrollohet nuk është i pranishëm, rolin e tij mund ta luajë një banues i kësaj banese që ka arritur pjekurinë ligjore. Nëse as kjo nuk është e mundur, gjatë kontrollit mund të jenë të pranishëm dy persona të paanshëm dhe të besuar. Kjo procedurë mund të shmanget vetëm nëse vonesa rrezikon hetimet.

Në rastin e kontrollit të mjediseve të punës, ekziston detyrimi i pranisë së njërit prej personave të përmendur në nenin 157 paragrafi 1 Z 2 deri 4, të pronarëve, i njërit prej përfaqësuesve ligjorë të tyre, apo i një personi i emëruar nga këta të fundit si përfaqësues i tyre.

(3) Gjatë kryerjes së kontrollit shqetësimet duhet të shmangen në masën më të madhe të mundur. Të drejtat individuale dhe të drejtat e pronës të të gjithë personave të prekur nga kontrolli duhet të ruhen sa më shumë që të jetë e mundur. Kontrolli i personave sipas përcaktimeve të nenit 117 Z 3 lit. b duhet të kryhet gjithmonë nga një person i të njëjtës gjini apo nga një mjek duke respektuar dinjitetin e personit që kontrollohet.

#### **Neni 122.**

(1) Policia kriminale duhet të lajmërojë prokurorinë lidhur me çdo kontroll të ndërmarrë në përputhje me përcaktimet e nenit 120 paragrafi fjalja e parë, si dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 100 paragrafi 2 Z 2). Pas kësaj, policia duhet të kërkojë vendimin e gjykatës lidhur me lejimin e kontrollit (Neni 99 paragrafi 3). Në rast se leja e gjykatës nuk jepet, atëherë prokuroria dhe policia kriminale duhet të përdorin mjetet ligjore në dispozicion të tyre në funksion të zbatimit të vendimit të gjykatës për vendosjen e ligjshmërisë.

(2) Nëse gjatë kontrollit zbulohen objekte që çojnë në konkluzionin se nëpërmjet tyre mund të kryhet një tjetër vepër e dënueshme nga ajo e cila i ka dhënë shkas kontrollit, këto objekte duhet të sekuestrohen, por në këtë rast duhet të ndiqet një protokoll i veçantë dhe të lajmërohet menjëherë prokuroria.

(3) Në çdo rast pala e prekur duhet njoftuar menjëherë, ose gjithësesi brenda 24 orësh, duke i dorëzuar një konfirmim lidhur me kontrollin dhe rezultatin e tij, si dhe eventualisht edhe urdhrin e prokurorisë së bashku me vendimin e gjykatës për zbatimin e sekuestros apo për heqjen dorë prej saj.

6. Neni 12 paragrafi 1a, 3,4,5 Ligji për Kontrollin Kufitar, BGBl. 435/1996 idF  
BGBl I Nr. 68/2013

## **Kontrolli kufitar**

### **Neni 12.**

(1) Kontrolli kufitar është detyrë e autoriteteve kufitare. Kontrolli kufitar është detyrë ekskluzive e organeve të ruajtjes së rendit publik, si përsa i përket anës administrative, ashtu edhe asaj operative, ku përfshihet ushtrimi i forcës. Veprimet zyrtare në kuadër të kontrollit kufitar realizohen mundësisht në pikën e kalimit kufitar dhe në çdo rast në zonën e kontrollit kufitar duke patur parasysh kriteret e proporcionalitetit, thjeshtësisë, shpejtësisë, efektivitetit të kostos.

(1a) Autoritetet kanë të drejtën e përdorimit të mjeteve për regjistrimin e figurës dhe zërit në kuadër të punës së tyre për kontrollin kufitar në pikat e kalimit kufitar. Autoritetet duhet ta vënë në dukje në mënyrë publike përdorimin e këtyre mjeteve. Autoritetet duhet të njoftojnë paraprakisht Ministrinë e Brendshme lidhur me qëllimin e tyre për të përdorur aparaturat për regjistrimin e zërit dhe figurës. Ministria është e detyruruar që të kërkojë mendimin e të ngarkuarit për mbrojtjen ligjore brenda tri ditësh sipas përcaktimeve të nenit 91a SPG. Përdorimi i aparaturave për regjistrimin e zërit dhe figurës është i mundur vetëm pas përfundimit të këtij afati treditör, apo pas dhënies së opinionit të të ngarkuarit për mbrojtjen ligjore, me përjashtim të rastit kur përdorimi i aparaturave është i domosdoshëm për shmangien e rreziqeve të mëdha në kuadër të hetimeve të menjëhershme.

(2) Ministri i Brendshëm, duke marrë parasysh nivelin e ulët të trafikut kufitar në një pikë të caktuar kufitare brenda BE-së, mund të vendosë që kontrolli kufitar në këtë pikë të kryhet vetëm në kuadër të patrullës kufitare, nëse një gjë e tillë nuk dëmton interesin publik apo detyrimet ndërkombëtare të shtetit.

(3) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuara të kontrollojnë personat që kalojnë kufirin, nëse ekzistojnë arsye që mbështesin supozimin, se kontrolli është i nevojshëm, ose nëse dyshohet se këta persona synojnë të kalojnë apo e kanë kaluar kufirin jo nëpërmjet pikës kufitar. Autoritetet kufitare kanë të drejtë të kontrollojnë këdo që kalon kufirin në pikat kufitare brenda territorit të kontrollit kufitar, si dhe në çdo pikë të territorit të kontrollit kufitar ku mendon se ka hasur një person që duhet kontrolluar; organet e kontrollit kufitar mund të kontrollojnë personin në çdo pikë të territorit të kontrollit kufitar ku ai është kapur në flagrancë duke kaluar kufirin në mënyrë të autorizuar jashtë pikës së kalimit kufitar.

(4) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar, në funksion të realizimit të kontrollit kufitar, që të verifikojnë identitetin e personit të kontrolluar, si dhe të dhënat e automjetit dhe bagazheve të tij, nëpërmjet inspektimit të jashtëm dhe të brendshëm; në rast se janë të pranishme organet doganore, atyre duhet tu jepet mundësia që të kryejnë kontrollin doganor krahas atij kufitar. Personat që i nënshtrohen kontrollit janë të detyruar të bashkëpunojnë për verifikimin e identitetit të tyre (neni 35 i ligjit të policisë - SPG, BGBl. Nr. 566/1991) duke u kujdesur që automjetet dhe bagazhet e tyre të mund të kontrollohen sa më lehtë. Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar të zbatojnë urdhrat e tyre për kontroll kufitar, në përputhje me përcaktimet e nenit 50, paragrafi 2 dhe 3 të SPG – nëpërmjet përdorimit të drejtpërdrejtë të urdhrave dhe të forcës detyruese.

(5) Organet kompetente për ruajtjen e rendit publik janë të autorizuar, në kuadër të mbikqyrjes së zbatimit të përcaktimeve të paragrafit të katërt, si dhe në kuadër të kryerjes së kontrollit kufitar, që të hyjnë në territore private, si dhe të përdorin shtigjet ekzistuese dhe të përshtatshme brenda tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës.

(6) Në pikat e kalimit kufitar, të cilat nuk i shërbejnë trafikut kufitar, por kryesisht apo ekskluzivisht interesave të pak banorëve, kontrolli kufitar kryhet nga autoritetet nëpërmjet një lejekalimi të thjeshtë. Gjithashtu zbatohen nenet 5a dhe 5b, duke patur parasysh se detyrimi për shlyerjen e taksave të mbikqyrjes u takon atyre, në interesin e të cilëve funksionon pika e kalimit kufitar.